



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 7818 prot.

Vlorë, më 21.05 2024

PROJEKT VENDIM

Nr. ____ datë ____ 2024

“Mbi miratimin e vendqëndrimeve të autoveturave taksi në Bashkinë Vlorë dhe kriteret për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi”

Këshilli i bashkisë i mbledhur sot me datën ____ 2024, mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, kreu VII, neni 23, pika 6, Ligjit Nr.8308 datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar kreu II.4, neni 35, Ligjit 8378 datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i RSH”, neni 7, pika 1f, Udhëzimit Nr.1649 date 16.08.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve” ndryshuar, kreu III, pika 2, udhëzimi Nr. 15 datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimet dhe çertifikatat për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, kreu VI, neni 21, kërkesës së Sindikatës së Pavaruar të taksistëve si dhe propozimin e Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Investimeve Publike për riorganizimin e vendparkimeve të autoveturave taksi dhe kriteret për organizimin dhe funksionimin e këtij shërbimi :

VENDOSI :

I-Të miratojë vendqëndrimet e mjeteve taksi 4+1 dhe taksi 8+1 në qytetin e Vlorës si më poshtë:

Nr	Vendndodhja	Nr.vend.	Pozicioni me rrugën
	<u>Taksi 4+1</u>		
1	Rruga “Irfan Shehu”(në fillim të rrugës nga ana e lulishtes)	5	Paralel
2	Rruga “Anita Bitri”(tek kapelja)	10	Paralel
3	Sheshi para AlbTelecomit	6	45°
4	Rruga”Janaq Kilica”(te Sh.H.Xhelo para stac.aut)	2	Paralel
5	Rruga”Demokracia”(në fund të rrugës majtas)	4	Paralel
6	Rruga “Demokracia”(mbas stacionit autb.interurb)	4	Paralel
7	Xhamia (përbri sh.Nr.I,te stacioni urban)	6	Paralel
8	Xhamia (para shkallëve të Kuzumbaba)	4	Paralel
9	Bulevardi”Ismail Qemali”(Kali i trojes afër stacionit të autobuzit)	6	Paralel



10	Bulevardi "Ismail Qemali" (përball lulishtesh te kali i Trojës)	6	Paralel
11	Bulevardi "Ismail Qemali" (tek tre Racat, përball Kinoteatrit "Petro Marko")	4	Paralel
12	Rruga "Kosova" (përball Rivierës)	4	Paralel
13	Rruga "Kosova" (mbas stacionit të autobusit përball Universitetit)	9	Paralel
14	Në fund të Rrugës "Veledin Kollozi", tek kryqëzimi në krahun e djathtë)	3	Paralel
15	Rruga "Hektor Shyti" (mbas Pallatit të Kulturës djathtas, te Porti)	3	Paralel
16	Tek Rrapi (para stacionit të autobusit urban)	5	Paralel
17	Në fund të rrugës "Pelivan Leskaj", te kryqëzimi	3	Paralel
18	Posta e Çoles (Rr.Zaho Koka, te kryqëzimi 3 vende majtas +3 vende djathtas, të spotuara)	6	Paralel
19	Rruga "Mitaq Sallata" (përball Spitalit nga dera e parë)	4	Paralel
20	Rruga "Gjergj Araniti" (te kryqëzimi me bulevardin Ismail Qemali, në të dy krahët nga 1 vend, mbas vijave të bardha)	2	Paralel
21	Kala	2	Paralel
22	Rruga "Gjergj Kastrioti" (kryqëzimi Tranballkanike me rrugën Enver Jaho", para rrethrotullimit)	5	Paralel
23	Rruga "Gjergj Kastrioti" (në fund të rrugës Transballkanike kur vete te karburant Vola)	5	Paralel
24	Rruga "Hasan Kushta" (te kryqëzimi me rr.Misto Mela, mbas tabakinos)	2	Paralel
25	Sheshi Flamurit (afër Hotel Vlora, në fillim të lulishtes së vorezave)	2	Paralel
26	Lungomare në krah të Hotel "Primavera" (mbas vijave të bardha)	2	Paralel
27	Lungomare përball Bar Taushani (rruga lidhëse lungomare –unazë)	4	Paralel
28	Lungomare në krah të Bar Hanover	3	Paralel
29	Te rruga "Pilo Begaj", (përball trekëndëshit te kisha)	3	Paralel
30	Kryqëzimi i rrugës "Rakip Malile" me rrugën "Dervish Hekali"	2	Paralel
31	Në fund të rrugës "Gjergj Kastrioti" (në krah të djathtë afër Kasttratit)	3	Paralel
	<u>Taksi 8+1</u>		
32	Tek trekëndëshi në hyrje të qytetit, në fillim	5	Paralel
	Njësia Administrative Oriku		
33	Bulevardi Princesha Rugjinë	6	Paralel



II-Të miratojë kriteret për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Bashkinë Vlorë:

1-Mjetet taksi 4+1:

- Të kenë ngjyrë të bardhë,

-Tipi i mjeteve taksi 4+1 të jetë i liberalizuar.

a- Për kompanitë e taksive(subjekte juridike) që licensohen për herë të parë, kërkohen mjete me vit prodhimi të njëjtë me vitin e licensimit (Km zero).Kompania e taksive duhet të ketë në pronësi jo pak se 5 mjete.

b- Për subjektet fizike me një mjet, që licensohen për herë të parë, viti i prodhimit për të gjitha tipet e mjeteve të jetë jo më shumë se 10 vjet në momentin e licensimit.

c-Mjetet taksi 4+1 që janë të licencuara nga bashkia dhe ushtrojnë aktivitetin, do të rilicensohen vetëm kur mosha e mjetit është jo më shumë se 15 vjet.Në rastin e rinovimit të mjetit brenda afatit të licencës, mjeti duhet të jetë jo më shumë se 10 vjet.

d-Mjetet taksi 4+1, që janë të licensuara nga bashkia, ushtrojnë aktivitetin në shërbimin taksi, por që nuk plotësojnë kushtin e mësipërm dhe afati i licencës ju përfundon në vitin 2024, 2025 do të rilicensohen me afat dy vjeçar, me të drejtë rinovimi të mjetit ku mosha e mjetit të jetë jo më shumë se 15 vjeçare.

2-Mjetet taksi 8+1:

-Të kenë ngjyrë të bardhë

-Tipi i mjeteve taksi 8+1 të jetë i liberalizuar.

-Viti i prodhimit të mjeteve taksi 8+1, që do të licensohen për herë të parë të jetë jo më shumë se 10 vjet në momentin e licensimit, ndërsa për mjetet që janë të licensuara, do të rilicensohen vetëm kur mosha e mjetit është jo më shumë se 15 vjet.

3-Të gjitha mjetet taksi duhet të jenë të pajisur me taksimetër

4-Subjektet që do të pajisen me licence taksie duhet të jenë të pajisura me dëshmi taksie nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor.

5-Mjeti taksi duhet të kryej aktvlerësimin teknik, që të plotësojë kushtet për të punuar taksi.

6-Subjektet e licensuara për transport udhëtarësh me taksi duhet të kenë shlyer detyrimet e tatim-taksave dhe sigurimeve shoqërore.

7-Subjektet e licensuara për transport udhëtarësh me taksi duhet të bëjnë sigurimin e detyrueshëm të pasagjerëve nga aksidentet.

8-Subjektet duhet të kenë një performancë të mirë kur do të licencohen për shërbim taksi, duke mos pasur dhe shkelje ligjore,

9-Të gjithë mjetet taksi 4+1 dhe 8+1, duhet të pajisen me Logon e Bashkisë Vlorë, të cilat do të vendosen në dyert e mjetit si dhe tabelën "TAXI"

10-Subjektet që do të licensohen për tu pajisur me licencë në shërbimin taksi të jenë me banim dhe seli në Vlorë.

III- Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr.68 datë 28.06.2018, shfyqizohet.

IV- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve, Policia Bashkiake dhe Ndërrmarja e Shërbimeve Publike.

V- Një kopje të këtij vendimi i dërgohet Policisë së Qarkullimit Rrugor Vlorë.

VI- Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

RELACION

“Mbi miratimin e vendqëndrimeve të mjeteve taksi në Bashkinë Vlorë si dhe kriteret për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi”

Mbështetur në Ligjit Nr.8308 datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar kreu II.4, neni 35, Ligjit 8378 datë 22.07.1998”Kodi rrugor i RSH”, neni 7, pika 1f, Udhëzimit Nr.1649 datë 16.08.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar” këshilli i bashkisë përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këtij shërbimi brenda territorit të vet si dhe vendqëndrimet e mjeteve taksi”.

Me VKB Nr.68 datë 28.6.2018, janë të miratuara vendqëndrimet e autoveturave taksi në qytetin e Vlorës si dhe kriteret për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi. Nga viti 2018 dhe në vazhdim numri i mjeteve taksi 4+1 është rritur, meqënëse tipet e autoveturave për shërbimin taksi 4+1 janë liberalizuar . Më shtimin e numrit të taksive 4+1 del domosdoshmëri e rritjes së vendqëndrimeve. Po ashtu në qytetin e Vlorës për shkak të investimeve infrastrukturore disa vende të përcaktuar në VKB janë mbyllur, si te 6-katëshi, sheshi Skelë, poliklinika, etj.

Në bazë të Ligjit 8378 datë 22.07.1998”Kodi rrugor i RSH”, neni 7, pika 1f, dhe Udhëzimit Nr.1649 datë 16.8.199, të ndryshuar, këshilli bashkiak i vetëqeverisjes vendore përcakton zona të destinuara për parkim, në të cilat qëndrimi i mjeteve kushtëzohet nga pagesa e një tarife që përcaktohet me Vendim të Këshillit Bashkiak dhe vendet e qëndrimit dhe të nisjes të taksive përcaktohen me VKB.

Sindikata e Pavarur e Taksitëve me shkresën Nr. 2982 prot. datë 26.02.2024 ka bërë kërkesë për shtimin e këtyre vendeve, si dhe nga kërkesat e vazhdueshme të vetë subjekteve taksi 4+1, për të bërë shtim të vendqëndrimeve të mjeteve taksi 4+1 në qytet. Drejtorja e Infrastrukturrës dhe Investimeve Publike ka bërë takime me këto grupe interesi, duke organizuar dëgjesa të ndryshme, verifikim në terren të të gjitha vendqëndrimeve, analizimin e të gjitha shqetësimeve të subjekteve, me qëllim që të luftohet informaliteti, taksitë pirate, duke bërë dhe një shpërndarje sa me racionale të këtyre vendqëndrimeve, me qëllim për tu shërbyer sa më mirë komunitetit dhe turistëve në qytet, paraqet këtë projekt vendim për vendqëndrimet e mjeteve taksi në Bashkinë Vlorë.

Në bazë të Ligjit Nr.8308 datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar kreu II,4,neni 35,” këshilli i bashkisë përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këtij shërbimi brenda territorit të vet ”.

Në bazë të Udhëzimit Nr.4 datë 25.04.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.12 datë19.07.2007”Për përcaktimin e numrit të autoveturave taksi, shtypjen dhe emetimin e bllokut të udhëtimit dhe rregjistrimit të shërbimit taksi”, pika 1 “Numri i licencave të lëshuara , në shkallë vendi, për shërbimin taksi me autovetura 4+1 vende do të jetë i pakufizuar”.

Në VKB Nr.68 datë 28.6.2018, kreu II, pika3,4 është përcaktuar viti i prodhimit të mjeteve që do te licensohen. Për mjetet 4+1 tip Benz viti i prodhimit ka qënë 2002 e lart dhe për tipet e tjera 10 vjeçare në momentin e licensimit. Duke qënë se numri i mjeteve taksi është i pakufizuar, kërkesat për licensim janë të larta, po ashtu kemi liberalizuar tipet e mjeteve, mendojmë se dhe viti i prodhimit të mjeteve që licensohen për herë të parë duhet të jetë i njëjtë për të gjitha tipet.

Mjetet taksi 4+1 dhe 8+1 të Bashkisë Vlorë do të kenë ngjyrë te bardhë, të jenë të pajisura me logon e bashkisë, me taksimetër, aktvlerësimi teknik që të plotësojë kushtet për të punuar taksi, sigurimin e detyrueshëm të pasagjerëve, subjektet para licensimit të kenë shlyer detyrimet e tatim-taksave dhe sigurimeve shoqërore, subjektet nuk duhet të kenë bërë shkelje ligjore me qëllim që të kenë një performancë sa më të mirë.

Duke qënë se është bërë liberalizimi i mjeteve taksi Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike paraqet propozimin që të ketë një unifikim të vitit të prodhimit të mjeteve taksi që licensohen për herë të parë. DIIP propozon:

1-Taksi 4+1: -Për kompanitë e taksive(subjekte juridike) që licensohen për herë të parë, kërkohen mjete me vit prodhimi të njëjtë me vitin e licensimit (Km zero).Kompania e taksive duhet të ketë jo më pak se 5 mjete.

- Për subjektet fizike që licensohen për herë të parë viti i prodhimit, për të gjitha tipet e mjeteve të jetë jo më shumë 10 vjeçare në momentin e licensimit.

-Mjetet taksi 4+1 që janë të licencuara nga bashkia dhe janë në aktivitet, do të rilicensohen vetëm kur mosha e mjetit është jo më shumë se 15 vjet, ndërsa për mjetet që nuk e plotësojnë kushtin e mësipërm, do të rilicensohen me afat dy vjeçar, me të drejtë rinovimi të mjetit .

2-Mjetet taksi 8+1: -Viti i prodhimit të mjeteve taksi 8+1 që do të licensohen për herë të parë të jetë jo më shumë se 10 vjet në momentin e licensimit, ndërsa për mjetet që janë të licensuara nga bashkia ,do të rilicensohen vetëm kur mosha e mjetit është jo më shumë se 15 vjet.

Duke u nisur nga sa më sipër kërkojmë nga Këshilli Bashkisë që të bëhet miratimi i këtij projektvendimi, për të pasur një shërbim taksi në cilësi sa më të mirë.


KRYETAR

Ermal Dredha




Hartat e vendqëndrimeve të taksive


Nr 1_5 Vende Parkimi



Nr 2_10 Vende Parkimi




Nr 3_6 Vende Parkimi




Nr 4_2 Vende Parkimi





Nr 5_4 Vende Parkimi




Nr 6_4 Vende Parkimi




Nr 7_6 Vende Parkimi



Nr 8_4 Vende Parkimi






Nr 9_6 Vende Parkimi




Nr 10_6 Vende Parkimi



Nr 11_4 Vende Parkimi




Nr 12_4 Vende Parkimi







Nr 13_9 Vende Parkimi



Nr 14_3 Vende Parkimi




Nr 15_3 Vende Parkimi



Nr 16_5 Vende Parkimi






Nr 17_3 Vende Parkimi




Nr 18_6 Vende Parkimi



Nr 19_4 Vende Parkimi




Nr 20_2 Vende Parkimi




KAT
KRETA
KRETA

Nr 21_2 Vende Parkimi



Nr 22_5 Vende Parkimi



Nr 23_5 Vende Parkimi



Nr 24_2 Vende Parkimi




Handwritten signature and stamp in blue ink.


Nr 25_2 Vende Parkimi




Nr 26_2 Vende Parkimi



Nr 27_4 Vende Parkimi




Nr 28_3 Vende Parkimi



Handwritten signature and initials in blue ink, including a small stamp with the letter 'B'.


Nr 29_3 Vende Parkimi



Nr 30_2 Vende Parkimi



Nr 31_3 Vende Parkimi




Nr 32_5 Vende Parkimi



Nr 33_6 Vende Parkimi

[Handwritten signature]
SHOPEXISE





ot: Nr 04

KERKESE



Date 20/02/2024

2882
26.02.2024

Per dijëni;

Drejtorise te transportit Bashkia Vlore

Lenda: Propozim mbi vendqëndrime te reja te shërbimit taksi ne Qytetin e Vlores

Per arsye te shtimit te mjeteve te licensuara per shërbimin taksi ne Qytetin tone Sndikata e Shqiperise e Taksive Dega Vlore propozone hapjet e reja te vendqëndrimeve Taksi si me poshtë:

- 1) 3 vendqendrimë te Rruga "DUSH STRATI" perballe fast food pitta fun me drejtim nga bulevardi.
- 2) 3 vendqendrimë ne bulevardi "ISMAIL QEMALI" perballe Kinoteatrit "PETRO MARKO" Ne krahë te lulishtes "TRE RACAT"
- 3) 3 vendqendrimë ne bulevardin "ISMAIL QEMALI" ne vendin e quajtur "Lulishtja e Kalit te Trojes" ne krahë te Bankes San Paolo
- 4) 3 vendqendrimë te Rruga "RESHAT OSMANI" ne krahë te Hotelit "PRIMAVERA"
- 5) 2 vendqendrimë te Rruga "FIQIRETE MUSTA" Ne krahë te Postes "ADEX"
- 6) 5 vendqendrimë te Rruga "ENVER JAHO" perballe Bankes INTESA SAN PAOLO
- 7) 3 vendqendrimë ne Rrugen "GJERGJ KASTRIOTI" (TRANSBALLKANIKE) 100 metra pa shkuar te karburanti Gega Oil
- 8) 3 vendqendrimë te Rruga "HASAN KUSHTA" (ALBANO&ROMINA)

Qellimi yne eshte qe te krijojmë nje harmoni ne shërbimin taksi ne Qytetin tone dhe te shmangim c'do lloje konflikti qe mundet te krijohet nga kjo situatë e tanishme ku vendet e taksive janë te pa mjaftueshme. Jemi te bindur se bashkëpunimi me Administraten Tuaj do te jete i frytshëm dhe efikas

ME RESPEKT :
KRYESIA E SINDIKATES SHQIPETARE E TAKSIVE
DEGA VLORE

KRYETARI

Dritan Rucaj

SEKRETARI

Andi Roshi

